

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Praktika profesionale
me zgjidhje

P12

Data 30/06/2018

Detyra 1

Adonisi ShA është kompani që prodhon një gamë të produkteve për vetura duke përfshirë karrige, panele të brendshme të plastikë dhe pjesë tjera nga fabrika e saj e vetme në një qytet të vogël në Kosovë. Të gjitha produktet punohen me porosi për një numër të prodhuesve të automjeteve në Evropë. Rreth 20% e popullsisë që punojnë janë të punësuar në Adonisi ShA, dhe kompania ka një reputacion për të qenë një punëdhënës i mirë me fokus të veçantë në ruajtjen dhe rritjen e përfitimeve për punonjësit e saj. Një universitet jo shumë larg këtij qyteti ka programe me lëndë specifike për punonjësit e mundshëm të Adonisi.

Edhe pse kompania është profitabile, pasqyrat e fundit meanxheriale tregojnë rënie të marzhave të fitimit me mundësinë e një humbje në vitin e ardhshëm, i pari në historinë 25 vjeçare të kompanisë. Arsyet kryesore për rënie të fitimeve janë identifikuar si rritja e konkurrencës nga prodhuesit në Lindjen e Largët dhe çështjet e vazhdueshme të kontrollit të cilësisë me disa prodhues kryesorë. Një studim i fundit i fizibilitetit tregon se duke lëvizur prodhimin në një vend të Lindjes së Largët do të mundësojë Adonisi të përfitojnë nga kostot e punës më të ulët dhe të afërsisë me furnizuesit e komponentëve të kualitetit të lartë. Funkcionet e administratës dhe të marketingut do të mbeten në vendndodhjen e tyre aktuale. Ndërsa një vendim përfundimtar ka ende për t'u bërë, Bordi është i vetëdijshëm për ndikimin negativ që mund të ketë kjo në imazhin e kompanisë dhe prandaj nuk janë të gatshëm të bëjnë ndonjë zotim të fortë për transferimin e prodhimit jashtë vendit.

Lëvizja e sistemeve të prodhimit në Lindjen e Largët është parë si një problem i veçantë për Adonisi. Fushat specifike të shqetësimit përfshijnë:

- (i) Marrja dhe mbajtja e furnizimeve nga furnizuesit e ri
- (ii) Ngritja e linjave të prodhimit me fuqi punëtore të re dhe makineri të reja
- (iii) Mirëmbajtja e stokeve të mjaftueshme të materialeve për të plotësuar nevojat, kur kohët e dërgesës të janë të pasigurta
- (iv) Zbatimi i çdo ndryshimi të nevojshëm në sistemet e kontabilitetit të menaxhimit

Megjithatë, Bordi është i bindur se ky veprim do të jetë i suksesshëm dhe është duke pritur një përgjigje pozitive nga punëtorët dhe aksionarët.

Kërkohe:

(a) Shpjegoni parimet kryesore të qeverisjes së shoqërive aksionere për kompanitë e listuara, me referencë të veçantë për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm dhe rolin e auditimit të brendshëm. **(5 pikë)**

(b) Identifikoni dhe vlerësoni çdo rrezik apo problem të mundshëm me sistemin e kontrollit të brendshëm në Adonisi ShA që dalin nga vendimi për të transferuar operacionet në Lindjen e Largët, shkurtimisht përshkruani metodat për të minimizuar këto rreziqe ose probleme.

(15 pikë)

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Qëllimi i qeverisjes së korporatave

Qeverisja e korporatave ka të bëjë me mënyrën në të cilën kompanitë qeverisen me qëllim të përgjithshëm të zbatimit të praktikave dhe të procedurave për të siguruar që një kompani është e drejtuar në përputhje me objektivat e saj. Parimi mbizotërues i qeverisjes lidhet me ndarjen midis pronësisë dhe kontrollit të një kompanie. Aksionarët e zotërojnë një kompani me blerjen e aksioneve dhe si rezultat i këtij rreziku të investimit, ata ndajnë përfitimet e pronësisë, pra dividendët e marrë. Megjithatë, drejtorët janë përgjegjës për të drejtuar kompaninë në baza ditore. Pasi që drejtorët janë agjentët e aksionarëve, ata duhet të sigurojnë se kompania është e drejtuar në dobi të aksionarëve; qeverisja e korporatave ofron funksion të kontrollit dhe raportimit për të treguar se interesat e aksionerëve janë duke u përmbushur.

Mund të ketë interesa të tjera që bordi i drejtorëve duhet gjithashtu të marrë parasysh në drejtimin e kompanisë të tilla si të punësuarit.

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Pjesë e detyrës së tyre të përgjithshme për drejtorët është ngritja e një sistemi të kontrollit të brendshëm për të siguruar që transaksionet janë të regjistruara dhe pasuritë e kompanisë janë të mbrojtura. Elementet kryesore të një sistemi të kontrollit të brendshëm janë përmbledhur në Britani të Madhe nga ana e raportit Turnbull, vendet e tjera kanë udhëzime të ngjashme.

Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të:

(1) Lehtëson funksionimin efikas dhe efektiv të një kompanie, duke bërë të mundur që ajo të përgjigjet ndaj rreziqeve të veçanta që mund të pengojë atë nga arritja e objektivave të kompanisë. Rreziqet mund të jenë operative, financiare ose të pajtueshmërisë, për shembull, me objektivat që kanë të bëjnë me zovgëlimin e humbjeve të pasurive ose të siguruarit që detyrimet janë kuptuar dhe menaxhuar.

(2) Sigurimi i cilësisë (menaxhimin) së raportimit të brendshëm dhe të jashtëm.

(3) sigurimi i përputhjes me ligjet dhe rregulloret dhe gjithashtu me politikat e brendshme të kompanisë në lidhje me udhëheqjen e përgjithshme të biznesit.

Megjithatë, ndërsa një sistem i shëndoshë i kontrollit të brendshëm nuk do të ofrojë siguri të plotë se situata e mësipërme nuk do të ndodhë, kjo ndihmojnë për të siguruar që mundësia e shfaqjes së tyre është minimizuar.

Auditimi i brendshëm

Një nga karakteristikat kryesore të një sistemi të kontrollit të brendshëm është krijimi dhe mirëmbajtja e një departamenti të auditimit të brendshëm, në fakt kjo është normalisht një kërkesë nga bursat për kompanitë e listuara të mëdha. Në auditim i brendshëm përcaktohet normalisht si 'një aktivitet vlerësim i pavarur i themeluar brenda një organizate, si një shërbim për të. Është një kontroll i cili funksionon, duke e shqyrtuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë dhe të efektivitetin e kontroleve të tjera'. Departamenti i auditimit të brendshëm për këtë arsye i ndihmon anëtarët e tjerë të organizatës në kryerjen e përgjegjësisë së tyre, nga bordi tek menaxherët junior në rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm, pra, do të shqyrtojë sistemin e kontrollit të brendshëm mbi menaxhimin dhe sistemet e financiare të kontabilitetit për të identifikuar dobësitë potenciale dhe aktuale.

(b) Problemet e mundshme me sistemet e kontrollit të brendshëm në Adonisi

Mungesa e veprimit të përshtatshëm

Duket se bordi i kompanisë kanë vënë në dukje problemin e mbajtjes së kapaciteteve prodhuese në vendin e tyre dhe të paktën një veprim të mundshëm të lëvizjes së kapaciteteve në një vend të Lindjes së Largët. Për më tepër, nuk është e qartë nëse bordi vlerëson seriozitetin e situatës, ose ka opsione të tjera, të tilla si zvogëlimi i kostos së prodhimit në vendin e tyre. Çfarë është e qartë

është se nevojiten disa veprime për të siguruar që kompania të mbetet në ekzistencë. Dështimin për të marrë veprim mund të rezultojë në dështimin e bordit për t'i kryer detyrat e tyre për aksionerët duke shkaktuar humbjen e investimeve të tyre dhe të ardhmen e rrjedhës së të ardhurave.

Mungesa e mundshme e përvojës së përshtatshme të menaxhmentit

Mungesa e veprimit të bordit çon në një tjetër dobësi të kontrollit të brendshëm siç është mungesa e talentit të përshtatshëm menaxherial dhe kontrollit në nivel të bordit. Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të sigurojë cilësinë e përgjithshme të menaxhimit. Mungesa e vendimit për zhvendosjen në Lindjen e Largët mund të shkaktohet thjesht nga mungesa e aftësisë menaxhuese ose do të marrë atë vendim të vështirë.

Jo-pajtueshmërisë me ligjet e Kosovës

Reduktimi i mundshëm në fuqinë punëtore në Kosovë do të thotë se shumë punonjës do të kenë të drejtë për kompenzim. Ekziston mundësia e shkeljes së ligjit të punës, qoftë e qëllimshme apo jo, i përpunimit dhe pagesës së rrogave. Auditimi i brendshëm do të duhet të rishikojë çdo llogaritje të kompenzimeve për largim nga puna në bazë testimesh për të siguruar pajtueshmëri me ligjin e punës

Jo-pajtueshmërisë me ligjet e Lindjes e Largët

Krijimi i një fabrikë në Lindjen e Largët do të thotë se Adonisi do të duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe rregullat e një vendi të huaj. Drejtorët duhet të sigurojnë që ligji në vend është kuptuar, ndoshta me punësimin e avokatëve vendor. Përndryshe, ekziston rreziku që Adonisi do të shkelë një ligj pa dashje e cila do të çojë në publicitet të dobët dhe, në ekstreme, mbylljen e fabrikës së re.

Rreziqet e përgjithshme të sistemeve të reja

Vendosja e një fabrikë të re në Lindjen e Largët do të thotë krijimin e menaxhmentit të ri dhe sistemeve të kontabilitetit financiar në atë vend. Sistemet e reja gjithmonë ka rrezik të dështojnë ose mund të ketë raportim të pasaktë për shkak të mungesës së testimi adekuat ose problemeve në implementim.

Rreziqet e komunikimit -Lindja e Largët në vendi

Krijimi i një vendi të ri të prodhimit do të thotë se kërkohet një komunikim i vazhdueshëm përmes raporteve të menaxhmentit në mes të dy vendndodhjeve. Ky system i ri i komunikimit do të ndikojë në rreziqe të tilla si ndërprerja e komunikimit ose informatat mund të pengohen gjatë transmetimit. Marrja me qira e kohës në një rrjet virtual privat do të ndihmojë për të ulur rrezikun e komunikimit.

Kontrolli i bordit

Distanca gjeografike nga Kosova në Lindjen e Largët mund të kufizojë aftësinë e bordit është për të ruajtur kontrollin e përshtatshëm të lokacionit të ri të prodhimit. Rreziku është se fabrika e re mund të prodhojë komponentët e saktë të kompjuterit, përballja me kufizimet e saj në lidhje me përzierjen e komponenteve të prodhuara ose raportin në mes të shitjeve dhe prodhimit. Për të ruajtur kontrollin adekuat, një drejtor mund të caktohet të jetë me vendbanim në lokacionin e ri.

Detyra 2

(a) Bëni dallimin në mes të takimit të përgjithshëm vjetor dhe takimit të përgjithshëm të jashtëzakonshëm. Shpjegoni qëllimin e secilit takim dhe përparësitë e mbajtjes së një takimi të jashtëzakonshëm të përgjithshëm për tu diskutuar çështjet e ngritura nga lajmëtarët.

(10 pikë)

(b) Shpjegoni KATËR role të drejtorëve joekzekutiv.

(10 pikë)

Zgjidhja

Takimet e përgjithshme vjetore janë pjesë e kalendarit financiar për kompanitë aksionare dhe ndodhin me rastin e prezantimit të rezultateve të fundvitit dhe publikimit të raportit vjetor. Takimet e jashtëzakonshme organizohen për të diskutuar çështjet strategjike dhe të tjera me aksionarët jashtë kalendarit normal financiar.

Qëllimi

Të dy llojet e takimeve janë takime zyrtare në mes të drejtorëve të kompanisë dhe aksionarëve të kompanisë. Zakonisht në këto takime ka prezantime nga bordi (zakonisht kryesuesi dhe/ose drejtori ekzekutiv) është është rast për aksionarët ti bëjnë pyetje bordit.

Takimet e përgjithshme vjetore (TPV)

TPV është pjesë zyrtare e vitit financiar të kompanisë. Qëllimi i TPV është të lejohet bordi të prezantojë rezultatet e vitit, diskutojë parashikimet për vitin e ardhshëm, prezantojë pasqyrat financiare të audituara dhe të kërkojë aprovimi i dividendave dhe kompenzimeve tjera për bordin. Aprovimi nga aksionarët bëhet përmes votimit të rezolutave. Është e zakonshme që bordi të bëjë propozime e pastaj të kërkojë aprovim nga aksionarët. Për shembull, dividend për aksion rekomandohet nga bordi por mund të paguhet vetëm pas votimit nga aksionarët. Aksionarët institucional mund të përdorin votat me prokurë (autorizim) nëse nuk janë në gjendje të marrin pjesë vetë.

Takimet e përgjithshme të jashtëzakonshme (TPJ)

TPJ zakonisht ftohen kur ka çështje për tu diskutuar ose aprovuar dhe nuk mund të pritët TPV. Viti i plotë është shumë i gjatë. Në disa mjedise biznesore kur ngjarjet kërkojnë ndryshim domethënës ose kërcënim, ftohet TPJ. Menaxhmenti mund të kërkojë ndonjë lëvizje strategjike të cilën nuk mund ta bëjë pa aprovimin e aksionarëve. Një rast tjetër që kërkon aprovim për një lëvizje strategjike është nëse një 'lajmëtar' do të shpalojë informatat që mund të dëmtojnë besimin e aksionarëve në bordin e drejtorëve.

(b)

Raporti Higgs (2003) ka shpjeguar funksionet e drejtorëve ekzekutiv në formën e katër roleve. Këto ishin roli strategjik, roli inspektues, roli i këshillimit ndaj rrezikut dhe roli i 'njerëzve'. Këto role mund të ndërmerren si pjesë e diskutimit të përgjithshëm që ndodhë në takime të bordit ose në formë më zyrtare sip pjesë e strukturës së komiteteve.

Roli strategjik kërkon që drejtorët joekzekutiv janë anëtarë të plotë të një bordi unik prandaj kanë të drejtë dhe përgjegjësi të kontribuojnë në suksesin strategjik të organizatës për të mirën e aksionarëve. Në këtë rol ata mund të sfidojnë çfardo aspekti të strategjisë që ata mendjnë se është e përshtatshme dhe mund të ofrojnë këshilla për të zhvilluar strategjinë e suksesshme.

Në rolin inspektues, drejtorët joekzekutiv kërkojë të mbajnë përgjegjës kolegët ekzekutiv për vendimet e marra dhe rezultatet e dhëna. Në këtë aspekt nga ata kërkojë t'i përfaqësojnë interesat e aksionarëve kundrejt mundësisë që të shfaqet problem i agjencisë i cili mund të ndikojnë zvogëlimin e vlerës së aksionarëve.

Roli i rrezikut përfshinë drejtorët joekzekutiv në sigurimin se kompania ka sistem të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm dhe sisteme të menaxhimit të rrezikut. Ky rol zakonisht

përshkruhet nga kodet e qeverisjes por disa kompani i nënshtrohen standardeve tjera ndërkombëtare siç është shembulli i International Organisation for Standardisation (ISO) standardet.

Në fund, roli i 'njerëzve' përfshinë drejtorët joekzekutiv në mbikqyrjen e një game të gjërë të përgjegjësive sa i përket menaxhmentit dhe anëtarëve ekzekutiv të bordit. Ky rol përfshinë çështjet e emërimit, kompenzimit por mund të përfshijë edhe çështje kontraktuale dhe disiplinore.

Detyra 3

Bordi i YGT ka diskutuar për informatat me kohë lidhur me rreziqet. Koncenzusi i takimit ishte që duhet të angazhohen konsulent të rrezikut për të rishikuar rreziqet me të cilat përballet kompania. Njëri nga drejtorët, Rita Duta, tha se ndihej se kjo është humbje e parave pasi që kompania duhet të fokusohet në përmirësimin e efikasitetit organizativ e jo vetëm në grumbullimin e informatave rreth rreziqeve. Ajo tha se shumë rreziqe nuk kishin ndryshuar shumë dhe rrallë janë materializuar prandaj shumica e këtyre rreziqeve mund të mos merren parasysh. Pjesa tjetër e bordit beson se një numër i rreziqeve janë shfaqur së voni ndërsa rreziqe tjera janë bërë më pak të rëndësishme, prandaj bordi dëshiron një vlerësim të tanishëm pasi që beson se vlerësimi i mëparshëm tashmë është jashtë kohe.

Ekipi i konsulentëve të rrezikut ka përfunduar auditimin e rrezikut. Ata kanë identifikuar dhe vlerësuar gjashtë rreziqe potenciale (A, B, C, D, E dhe F) dhe janë diskutuar informatat në vijim pasi që janë prezantuar para bordit të YGT:

Rreziku A është vlerësuar që ka pak mundësi të ndodhë dhe ndikimi i tij është i ulët, deri sa Rreziku B është vlerësuar që ka mundësi ta madhe të ndodhë dhe ka ndikim të madh.

Mirëpo aktivitetet që ndikojnë në shfaqjen e rreziqeve A dhe B konsiderohen shumë të largëta, për derisa të njëjtat aktivitete kanë vlerë dhe janë të afta të gjenerojnë fitim të mirë.

Rreziku C është vlerësuar me probabilitet të ulët por ka ndikim të lartë dhe po ashtu shfaqet për shkak të aktivitetit i cili nuk duhet të ndërpritet edhe pse ka alterantiva për të përballuar këtë rrezik. Aktiviteti që ndikon në shfaqjen e Rrezikut C ka filluar tash së voni nga kompania YGT si rezultat i lansimit të një produkti të ri.

Rreziku D është vlerësuar me mundësi të madhe të ndodhjes por me ndikim të vogël dhe është shfaqur si rezultat i një ndryshimi të fundit në legjislacion. Ndaj këtij rreziku as nuk mund të bëhet sigurimi përmes kompanive të sigurimit e as nuk mund të bartet tek të tjerët. Është me rëndësi strategjike për kompaninë të vazhdohet me aktivitetin i cili ndikon në shfaqjen e Rrezikut D edhe pse jo në nivel të njëjtë të rrezikut siç është tani.

Përveç kësaj, janë identifikuar Rreziqet E dhe F. Rreziku E është rrezik ambientalist dhe Rreziku F është klasifikuar si rrezik i reputacionit. Konsulentët e rrezikut thanë që Rreziku E dhe F mund të jenë rreziqe të lidhura. Në përgjigjen zyrtare bordit të YGT, konsulentët thanë se kompania duhet të zhvillojë kulturë të vetëdijësimit ndaj rreziqeve dhe ko duhet të bëhet në të gjitha nivelet e kompanisë.

Kërkohet:

(a) Kritikoni mendimin e Rita lidhur me nevojën për vlerësim të rrezikut. Shpjegoni pse rreziqet janë dinamike dhe prandaj duhet të vlerësohen në mënyrë të rregullt. (8 pikë)

(b) Duke përdorur kornizën ' Transfero, Zvogëlo, Prano, Shmang' rrezikun, përzgjedhni dhe shpjegoni strategjinë e përshtatshme për secilin rrezik (A, B, C dhe D). Arsyejtoni përzgjedhjen në secilin rast.

(6 pikë)

(c) Shpjegoni çfarë janë 'rreziqet e lidhura' dhe përshkruani se si mund të jenë të lidhura Rreziku E dhe Rreziku F.

(6 pikë)

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

a) Rita e ka gabim në të dy pohimet e saj. Besimi se rreziqet nuk ndryshojnë shumë është i vërtetë vetëm në një mjedis statik.

Në realitet, ndryshueshmëria e rreziqeve varet nga pozita e organizatës në vazhdueshmërinë në mes të dinamizmit të lartë dhe statikës së plotë. Rasti përmend disa ndryshime në rreziqet e YGT dhe kjo sygjeron se ka dinamizëm në mjedisin e organizatës. Prandaj është e qartë se besimi i sra është shumë i vështirë për tu mbrojtur.

Besimi i saj duke thënë se rreziqet vështirë se materializohen ndonjëherë mund të jetë historikisht i vërtetë (por edhe kjo ka pak mundësi të ndodhë ashtu) por vlerësimi i rrezikut ka nënvizuar së paku dy rreziqe që mund të materializohen. Rreziku D është vlerësuar me mundësi të madhe të ndodhjes dhe Rreziku B po ashtu ka mundësi të ndodhjes me mundësi të ndikimit të madhë. Asnjëra nga këto variabla nuk do të ishin të njohura nëse nuk do të kishte vlerësim të rreziqeve. Është me rëndësi, Rreziku B është rrezik i lartë/lartë që do të thotë ka mundësi të lartë të ndodhjes me ndikim të lartë. Nëse nuk jemi të vetëdijshëm për këtë rrezik kjo do të shkaktonte dëm të madh për organizatën.

Pse vlerësimi i rrezikut është dinamik

Vlerësimi i rrezikut është aktivitet dinamik i menaxhmentit për shkak të ndryshimeve në mjedisin organizativ dhe për shkak të ndryshimeve në aktivitetet dhe operacionet e organizatës të cilat bashëveprojnë me atë mjedis. Te YGT, rasti përkrahet Rrezikun C si rrezik që shfaqet për shkak të ndryshimit të aktivitetit në kompani: lansimi i një produkti të ri. Produkti i ri është e qartë që ka paraqitur një rrezik të ri i cili nuk ka ekzistuar më parë. Mund të jetë obligim i mundshëm nga përdorimi i produktit ose humbje e mundshme nga materialet e përdorura në prodhimin e këtij produkti.

Ndryshimet në mjedis mund të përfshijnë ndryshimet politike, ekonomike, sociale ose teknologjike ose çfardo ndryshimi në nivel të industrisë siç është ndryshimi në sjelljen konkurruese të furnitorëve, blerësve ose konkurrencës. Në cilin do rast, mund të paraqiten rreziqe të reja, rreziqet ekzistuese mund të bëhen më të mundshme ose mund të kenë ndikim më të madhose e kundërta.

b) Transfero, Zvogëlo, Prano, Shmang

Strategjitë për secilin vlerësim të rrezikut janë siç vijon:

Rreziku A është Prano. Kjo do të thotë se mundësia e ndodhjes është aq e ulët që edhe nëse materializohet nuk do të ketë efekt të madh.

Risk B është Shmang. Kur mundësia e ndodhjes dhe ndikimi janë të larta, nuk do të ishte racionale të pranohet ky rrezik, prandaj duhet të shmanget. Kjo mund të përfshijë ndryshimin e sjelljes ose ndërprerjen e aktiviteteve të caktuara. Rasti thotë se aktiviteti që shkakton këtë rrezik është i aftë të ofroj fitim mirëpo është e rëndësishme që nuk është vitale në aspektin strategjik.

Duke u bazuar në këtë fakt, dhe pasi që rasti nuk ofron mundësi të transferimit të këtij rreziku, atëherë nuk është e nevojshme pranimi i këtij rreziku.

Rreziku C është Transfero. YGT thotë se aktiviteti që ndikon në shfaqjen e këtij rreziku nuk guxon të ndërpritet (dmth shmangia nuk është një opsion) dhe specifikon se ky rreziku mund të transferohet. Për të transferuar rrezikun do të thotë ndarja e rrezikut me një palë tjetër. Mënyra më e mirë është sigurimi tek kompanitë e sigurimit.

Rreziku D është Zvogëlo. Rasti thekson se rreziku nuk mund të transferohet por që aktiviteti që ndikon në shfaqjen e tij mund të reduktohet. Zvogëlimi përfshinë ekspozimin e zvogëluar duke e kryer aktivitetin në një mënyrë tjetër.

(c)

Rreziqet e lidhura janë rreziqe që ndryshojnë për shkak të pranisë së një rreziku tjetër. Kjo do të thotë se ato rreziqe nuk ekzistojnë të pavarura dhe ka mundësi të rriten ose zvogëlohen varësisht nga rreziku tjetër.

Rreziqet mjedisore përfshijnë ekspozimin ndaj humbjeve që dalin nga konsumimi i burimeve nga organizata ose përmes ndikimit nga ndotja. Kur një rrezik mjedisor ndikon në situatën sensitive (qoftë njerëzore, bimore, shtazore etj), kjo mund të shkaktojë publicitet negativ që mund të rezultojë në dëmtim të reputacionit. Këto dy rreziqe mund të kenë shkaktar të njëjtë, dmth shfaqen dhe zhduken së bashku nga aktiviteti i njëjtë. Konsiderohen si rreziqe të ndara sepse mund të ndodhin humbje nga cilido ndikim (mjedisor ose i reputacionit).

Aktivitetet e dizajnuara për të zvogëluar rrezikun mjedisor, siç është përftimi i burimeve nga vendet më pak të ndjeshme nga aspekti mjedisor ose përmes kontrollimit të ndotjes, do të zvogëlojë mundësinë e realizimit të rrezikut mjedisor. Kjo pastaj do të zvogëlojë mundësinë e ndodhjes së rrezikut të reputacionit.

Detyra 4

(b) Kontrolli i brendshëm dhe auditimi konsiderohen si pjesë të rëndësishme të një qeverisje të fortë të korporatës.

Kërkohe:

- (i) Përshkruani PESË objektiva të përgjithshme të kontrollit të brendshëm. (5 pikë)
(ii) Përshkruani faktorët organizativ që përcaktojnë nevojën për auditim të brendshëm në kompanitë e listuara. (5 pikë)

b) Raporti Turnbull në Mbretërinë e Bashkuar thekson disa elementë të një mjedisi të fortë të kontrollit.

Kërkohe:

Numëroni dhe shpjegoni këto element sipas raportit Turnbull (10 pikë)

Zgjidhja

PESË objektiva të përgjithshme të kontrollit të brendshëm

Kontrolli i brendshëm përbëhet nga një rrjet i sistemeve të themeluara në një organizatë me qëllim të ofrimi të sigurisë së arsyeshme se janë duke u përmbushur objektivat e organizatës. Këto objektiva të kontrollit të brendshëm janë:

Të siguroj kryerje me rregull dhe në mënyrë efikase të biznesit sa i përket vënjes në funksion të sistemeve.

Kontrollet do të thotë se proceset dhe transaksionet e biznesit janë duke ndodhur pa pengesë me më pak rrezik dhe në të njëjtën kohë kjo i shton vlerë aksionarëve.

Të ruaj pasuritë e biznesit. Pasuritë përfshijnë ato të prekshme dhe të paprekshme dhe kontrollet janë të domosdoshme të sigurojnë se ato pasuri jaën duke u përdorur në mënyrë optimal dhe janë të mbrojtura nga keqpërdorimi, mashtrimi dhe vjedhja.

Të parandalojë dhe zbulojë mashtrimin. Kontrollet janë të domosdoshme të tregojnë çfardo mospërputhje financiare që mund të jetë rezultat i mashtrimit ose vjedhjes. Kjomund të përfshijë financim jashtë-bilancor ose përdorim të pautorizuar të politikave kontabël, kontrolleve mbi stoqet ose pronës së kompanisë.

Të siguroj plotësi dhe saktësi të të dhënave kontabël. Sigurimi se të gjitha transaksionet e kontabilitetit janë regjistruar me saktësi, se pasuritë dhe detyrimet janë identifikuar në mënyrë të saktë dhe të gjitha kostot dhe të hyrat janë regjistruar.

Të siguroj përgatitje me kohë të informatave financiare që ka të bëjë me kërkesat ligjore (psh raportimi vjetor) dhe me pasqyrat menaxheriale për të ndihmuar vendimmarrje efektive nga menaxhmenti.

(ii) Faktorët që ndikonë në nevojën për auditim të brendshëm dhe kontrolle (Bazuar pjesërisht në udhëzuesin Turnbull)

Natyra e opearacioneve brenda organizatës që paraqiten nga sektorët, pozicionimi strategjik dhe aktivitetet kryesore.

Shkalla dhe madhësia e operacioneve përfshirë faktorët siç është numri i punonjësve. Në përgjithësi supozohet se sa më e madhe dhe komplekse të jetë organizata, aq më shumë ka nevojë për kontrolle të brendshme dhe auditim.

Konsiderimi i kostos dhe përfitimit. Menaxhmenti duhet të matë përfitimet nga themelimi i kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të auditimit kundrejt kostos së kryerjes së atyre funksioneve. Kjo ka mundësi të jetë çështje për kompani të mesme ose kompani që janë duke u rritur.

Ndryshimet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në aktivitete, struktura ose rreziqe. Ndryshimet që paraqiten me produktet e reja ose aktivitete të brendshme mund të ndryshojnë nevojën për auditim të brendshëm. Problemet me sistemet ekzistuese, produktet ose procedura përfshirë ngjarjet e pashpjegueshme. Problemet që përsëriten mund të rrisin nevojën për kontrolle të brendshme dhe auditim. Nevoja që kompania të jetë në pajtueshmëri nga kërkesat e jashtme siç janë rregullat e bursave të këmbimit, ligjet etj.

b) Raporti Turnbull në Mbretërinë e Bashkuar thekson disa elementë të një mjedisi të fortë të kontrollit:

- **Strategji** të qarta për sa i takon trajtimit të rreziqeve të rëndësishme që janë identifikuar
- **Kultura e kompanisë, kodet e sjelljes, politikat dhe praktikat për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe sistemet e shpërblimit të performancës që mbështesin** objektivat e biznesit bashkë me menaxhimin e rrezikut dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm
- Menaxhmenti i lartë demonstroi me anë të veprimeve dhe politikave të tij angazhimin ndaj **kompetencave, integritetit dhe kujdesjes ndaj një klime të mirëbesimit** brenda për brenda kompanisë
- **Përkufizim i qartë i autoriteteve, përgjegjësi dhe dhënies së llogarisë** në mënyrë që vendimet dhe veprimet të merren nga njerëzit e duhur
- **Komunikimi** me punonjësit për sa i takon asaj që pritet prej tyre dhe shtrirja e lirisë së tyre të veprimit
- Njerëzit në kompani kanë **njohuritë, aftësitë dhe mjetet e duhura** për të mbështetur arritjen e objektivave të organizatës dhe për të menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet e saj.

Detyra 5

Në një fjalim të rëndësishëm, ministri i financave i shtetit G tha se industria e auditimit dhe ofrimin të sigurisë gjithmonë duhet të gjykohej nga efekti që ka ajo në besimin e publikut në biznes. Ai tha se është e rëndësishme që shërbimet profesionale siç është auditimi duhet të kryhen në interesin publik dhe nuk duhet të ketë kërcënime ndaj pavarësisë së auditorëve. Kanë ndodhur dështime të korporatave të mëdha siç është rasti i Enronit për shkak se disa auditor nuk e kanë ditur se çka do të thotë të veprosh në interes publik. Ai më tutje tha se firmat nuk duhet të ofrojnë më shumë se një shërbim për klientët.

Urimi, një gazetar që gjendej në audiencë dhe që kishte përvojë të mëparshme në auditim sugjeroj se këshilla për kërcënimet e pavarësisë nuk ishte e saktë. Në fakt është e kundërta, sipas tij, aq më shumë shërbime që i ofrojnë auditorët klientëve të tyre, aq më mirë, pasi që i mundëson klientit të kuptojë më mirë nevojat komerciale për kontabilitet. Ministri nuk u pajtua me këtë konstatim duke thënë se këndvështrimet e gazetarit ishin shembuj të mirë të firmave të auditimit që nuk veprojnë në interesin publik.

Urimi tha se kur ishte partner në një firmë të madhe për ofrimin e shërbimeve profesionale, ai i njihte klientët e tij shumë mirë përmes lidhjeve të shumëfishta që firma kishte me ata. Ai tha se dinte gjithçka për financat e tyre deri sa i auditonte, gjithçka për çështjet tatimore dhe ishte gjithmonë në pozitë të mirë për t'iu ofruar këshilla. Ai po ashtu u bë edhe shok shumë i mirë me drejtorët e kompanive të klientëve.

Klientët, shpjegoj ai, po ashtu e kanë shikuar këtë marrëdhënie si të dobishme.

Një gazetar tjetër, Ganiu, reagoi ndaj konstatimeve të kolegut të tij duke e cilësuar atë si përfaqësuesin më të keq të profesionit të auditimit. Ai tha se auditimi është i njëanshëm dhe i mbivlerësuar dhe i ka shërbyer vetëm një grupi të vogël të aksionarëve, është bashkëpjesëmarrës në degradimin ambjentalist dhe nuk mund ti shërbejë interesit publik për deri sa i shërben kapitalizmit të parregulluar.

Ai tha se auditimi nuk i shërben interesit publik pasi që nuk adreson varfërinë, të drejtat e kafshëve ose padrejtësitë tjera sociale.

Kërkohet:

(a) Shpjegoni, duket përdorur auditimin si shembull, çka është 'interesi publik'. (6 pikë)

(b)

(i) Duke iu referuar rastit, përshkruani pesë lloje të kërcënimeve etike. (6 pikë)

(ii) Vlerësoni kërcënimet etike që nënkuptohen përmes gazetarit të parë. (8 pikë)

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

a)

Interesi publik është mirëqenja e përgjithshme e shoqërisë si dhe interesi i aksionarëve të një kompanie të caktuar. Në përgjithësi supozohet se psh, të gjitha veprimet profesionale, qoftë nga profesionistët mjekësor, ligjor ose të kontabilitetit, duhet të bëhen për të mirën e përgjithshme e jo për interesin e një grupi të caktuar.

Kontabiliteti ka një ndikim të madh prandaj 'testi' për interesin publik është i rëndësishëm.

Ministri ka bërë një referencë specifike auditimit dhe shërbimeve për ofrimin e sigurisë. Në auditim, psh, puna e tregjeve kapitale dhe kështu edhe vlera e të hyrave nga tatimet, përnacionet, investimet – i përket sjelljes së kontabilistëve. Në kontabilitetin menaxherial dhe në menaxhmentin financiar, stabiliteti i organizatave biznesore dhe kështu është siguri i vendeve të punës dhe furnizimi me produkte të rëndësishme po ashtu varet nga sjellja profesionale e kontabilistëve.

(b) Kërcënimet etike

(1) Kërcënimi i interesit vetiak, që mund të ndodhë si rezultat i interesit financiar ose tjetër i kontabilistit profesionit ose një anëtari të familjes së ngushtë.

(2) Kërcënimi i vetë-rishikimit, që mund të ndodhë kur një gjykim i mëparshëm duhet të rivlerësohet nga kontabilisti profesionit që ishte përgjegjës për atë gjykim;

(3) Kërcënimi i avokimit, që mund të ndodhë kur një kontabilist profesionit promovon pozitën ose opinionin deri në atë masë sa që mund të komprometohet objektiviteti i tij/saj;

(4) Kërcënimi i njohjes. Që mund të ndodhë për shkak të marrëdhënies së ngushtë, kontabilisti profesionit bëhet tepër i ndjeshëm ndaj interesave të të tjerëve;

(5) Kërcënimi i frikësimit, që mund të ndodhë kur kontabilisti profesionist mund të pengohet të kryej punën me objektivitet.

Në rastin tonë ka kërcënime të njohjes përmes ofrimit të shërbimeve të shumëfishta ndaj klientit të njëjtë. Mungesa e paanësisë mund të shkaktojë kërcënimin e avokimit, pasi që firma mund të promovojë klientin përmes kryerjes së punëve tjera përveç auditimit. Shkalla e lartë e varësisë që firma ka nga klienti mund të shkaktojë kërcënimin e frikësimit. Sa më e varur të bëhet firma nga të ardhurat nga klienti, aq më shumë do të joshet të ofrojë gjykim të favorshëm të auditimit, sepse frikohet se mund ta humbë klientin. Interesi vetiak mund të paraqitet pasi që anëtarët senior të firmës së auditimit e mbrojnë pozitën e tyre financiare kundrejt interesit publik.